

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI IPËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi si dhe sekretaren juridike Vildane Azemi-praktikante në këtë gjykat, në çështjen penale kundër të pandehurve L.V.1 dhe A.H., për shkak të veprën penale shtrëngim nga neni 195 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1542-1/13 të dt.16 Janar 2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, të dëmtuarës D.V. dhe të pandehurve L.V.1 dhe A.H., me datë 02 Dhjetor 2016 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 15 Dhjetor 2016 përpiloi me shkrim këtë:

### A K T G J Y K I M

**1. I akuzuari L.V.1** data e lindjese...., nga i ati Xh. e ëma Xh., e gjinisë Z., me vendbanim në Fshatin .....Komuna Shtime, me profesion mekanik, i pamartur, i gjendjes së mesme ekonomike, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**2. I akuzuari A.H.** data e lindjese...., nga i ati S. e ëma E. e gjinisë Rr., me vendbanim në Fshatin ..... Komuna Shtime, me profesion shofer, si dhe pronar i mobilerisë “.....”, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### JANË FAJTOR

Sepse me datë 7 Maj 2013, rreth orës 18:35, në rrugën “ Gjon Serreqi”, në Ferizaj, me përdorimin e forcës e kanë detyruar të dëmtuarën të pajtohet me një veprim, në atë mënyre që i pandehuri i parë ka kërkuar nga e dëmtuara që të hyjë në veturë, pas refuzimit të saj e kap për krahu duke e tërhequr, me të vërejtur këtë i pandehuri i dytë del nga vetura dhe e kap për flokë të dëmtuarën dhe me anë të forcës e fusin në veturën Peugeot, me qëllim që e dëmtuara të mos ta ndërpres lidhjen që e kishte me të pandehurin e parë.

**me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale shtrëngimi nga neni 195 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.**

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 1, 3, 11, 32, 33, 34, 36, 41, 43, 44, 64, 65, të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së,

### G J Y K O N

- *ME DËNIM ME GJOBË SECILIN VET A VET, në lartësi prej 800€ /tetëqind euro/, të cilin gjobë janë të obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.*
- *Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.*
- *E dëmtuara: L.V.2, me vendbanim ne .....në Shtime, per realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet ne kontest civilo - juridike.*
- *Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë në mënyrë solidare të paguaj shumën prej 50 €, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.*

### A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurin gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/II.nr.1542-1/13 të dt. 16.01.2016, ka ngarkuar të pandehurit L.V.1 dhe A.H. se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të shtrëngimi nga neni 195 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.12.2016, në të cilën shqyrtim fillestar: *i akuzuari L.V.1 është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin për veprën penale të kryer si dhe i kërkoj falje publike të dëmtuarës, ndërsa gjykatës i premtoj se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre.*

*I akuzuari A.H. është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke shprehur keqardhje për këto vepra penale, i kërkoje falje publike të dëmtuarës, si dhe gjykatës i premtuar se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre.*

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarve, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit të i shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësorë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 383 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarve gjatë procedurës hetimore dhe në shqyrtimin fillestar, deklarata e të dëmtuarës D.V. datës: 07.05.2013, deklarata e dëshmitarit R.L. e datës 08.05.2013, deklarata e dëshmitares L.V.3 e datës 08.05.2013, deklarata e dëshmitarit A.V. e dt. 07.05.2013, si dhe pjesërisht deklarata e të pandehurve L.V.1 dhe A.H. e datës 08.05.2013, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cili është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale shtrëngimi nga neni 195 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, se me datë 7 maj 2013, rreth orës 18:35, në rrugën “Gjon Sereqi”, me përdorimin e forcës e kanë detyruar të dëmtuarën të pajtohet me një veprim, në atë mënyrë që i pandehuri i parë ka kërkuar nga e dëmtuara që të hyjë në veturë, pas refuzimit të saj e kap për krahu duke e tërhequr, me të vërejtur këtë i pandehuri i dytë del nga vetura dhe e kap për flokë të dëmtuarën dhe me anë të forcës e fusin në veturën Peugeot, me qëllim që e dëmtuara të mos ta ndërpres lidhjen që e kishte me të pandehurin e parë.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në të gjitha fazat e procedurës penale ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se i pandehuri deri tani nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga

kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë në mënyrë solidare të paguaj shumën prej 50 €, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurve.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I  
PËRGJITHSHËM,P.nr. 57/14 dt. 15.12.2016**

**Sekretare juridike,  
Vildane Azemi**

**Gjyqtari Individual,  
Ilir BYTYQI**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.